

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA” FAKULTETI JURIDIK

Studimet Master: Kushtetues--Administrativ

Kandidatja: Ardita Ademi

Mentori: Prof,Dr. Arsim Bajrami

Tema: *Trajtimi Kushtetues i Minoriteteve në Republikën e Kosovës*

Abstrakti

Pakicë apo minoritet etnik nënkuptohet një grup njerëzish me prejardhje të ndryshme etnike për dallim nga shumica e popullatës që jeton në një shtet. Në çdo shtet të botës ekzistojnë pakicat kombëtare, por jo në çdo vend atyre u njihet statusi ligjor, të drejtat themelore, përfaqësimi në institucione, përdorimi i gjuhës dhe simboleve kombëtare.

Kosova pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008 është përfshirë në një proces të rëndësishëm tranzicioni në drejtim të fuqizimit të pavarësisë dhe sovraniteti shtetror, në drejtim të ndërtimit të institucioneve shtetërore demokratike si parakusht për të siguruar një shoqëri të qëndrueshme dhe shumë-etnike. Një ndër përmasat themelore që një synim i tillë të arrihet ishte edhe vazhdon të jetë përfshirja e komunitetit pakicë pavarësisht grupit etnik që i takojnë, brenda sistemit kushtetues dhe juridik të vendit si dhe integritet sa më i gjerë i tyre, në strukturat e pushtetit qoftë në nivel lokal apo qendror.

Të gjithë qytetarët e Kosovës janë të mbrojtur me ligj nga diskriminimi qoftë direkt apo në mënyrë të tërthortë mbi baza të identitetit etnik, kulturor, gjuhësor apo religjioz. Në këtë aspekt Republika e Kosovës garanton që të gjitha komunitetet t'i gëzojnë në mënyrë tërësisht të barabartë të drejtat e tyre elementare, duke ndërmarrë masa adekuate për përmirësimin e situatave ku këta persona mund të përjashtohen si barabartë i të drejtave të tyre.

Përfaqësimi i minoriteteve në Institucionet e Republikës së Kosovës.

Fjalë kyçe: Pakicë apo minoritet etnik , Kosova pas shpalljes së Pavarësisë, mbrojtja e minoriteteve me ligj, përfaqësimi i minoriteteve në Institucionet e Republikës së Kosovës.